



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANATI

Nr. 25/5 Prot

Tiranë, më 31.10.2025

VENDIM

Nr. 93 datë 31/10/2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROMOVIMIN E ARRITJEVE
KËRKIMORE-SHKENCORE DHE NXITJEN E INOVACIONIT TË
STUDENTËVE DHE PERSONELIT AKADEMIK NË FAKULTETIN E
GJUHËVE TË HUAJA TË UT-SË

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49 pika 6 në Statutin e UT-së, Dekanati i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, nëpërmjet e-mailit qarkullues të datës 31.10.2025:

VENDOSI:

1. Të miratojë;

- Rregulloren për promovimin e arritjeve kërkimore-shkencore dhe nxitjen e inovacionit të studentëve dhe personelit akademik në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT-së.

2. Vendimi i përcillet të gjitha njësive bazë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKAN

Prof.Dr. Esmeralda KROMIDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

**RREGULLORE PËR PROMOVIMIN E ARRITJEVE KËRKIMORE-SHKENCORE DHE
NXITJEN E INOVACIONIT TË STUDENTËVE DHE PERSONELIT AKADEMIK
NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA, UNIVERSITETI I TIRANËS**

Miratuar me Vendim Dekanati

Nr. 93, datë 31.10.2025



**RREGULLORE PËR PROMOVIMIN E ARRITJEVE KËRKIMORE-SHKENCORE DHE
NXITJEN E INOVACIONIT TË STUDENTËVE DHE PERSONELIT AKADEMIK
NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA, UNIVERSITETI I TIRANËS**

Neni 1 – Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e promovimit, vlerësimit dhe mbrojtjes së arritjeve kërkimore-shkencore dhe inovative të studentëve të programeve të studimit Bachelor, Master dhe Doktoratë, si edhe të personelit akademik në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

Neni 2 – Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

1. Ligjin nr. 80/2015, *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*;
2. Ligjin nr. 35/2016, *“Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”*;
3. Ligjin nr. 9947/2008, *“Për pronësinë industriale”*;
4. Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës;
5. Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për promovimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit në arsimin e lartë

Neni 3 - Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për:

- studentët e të gjitha cikleve të studimeve (Bachelor, Master dhe Doktoratë) në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës;
- personelin akademik dhe kërkimor të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;
- bashkëpunëtorët e jashtëm që marrin pjesë në veprimtari kërkimore në bashkëpunim me fakultetin.

Neni 4 - Objektivat

Kjo rregullore synon të:

1. nxisë studentët për të marrë pjesë në projekte kërkimore-shkencore dhe në aktivitete inovative;
2. promovojë punimet më të mira në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti;



3. zhvillojë kulturën e kërkimit shkencor dhe të sigurojë respektimin e të drejtave të autorit;
4. forcojë bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe personelit akademik në nisma kërkimore me fokus në shkencat gjuhësore, letërsinë botërore moderne dhe postmoderne, përkthim, interpretim, kulturë dhe teknologji digjitale;
5. nxisë përfshirjen e rezultateve kërkimore në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 5 – Forma e promovimit

Promovimi i arritjeve kërkimore realizohet përmes:

- konferencave dhe forumeve shkencore studentore;
- dhënies së çmimeve të nderit ose certifikatave të mirënjohjes (p.sh. “Punimi më i mirë shkencor”);
- botimeve në revista shkencore të Fakultetit ose të Universitetit;
- prezantimeve publike, ekspozitave dhe konkurseve të inovacionit dhe teknologjisë gjuhësore;
- publikimeve në faqen zyrtare të Fakultetit, në mediat sociale të tij dhe në rrjetet akademike bashkëpunuese.

Neni 6 – E drejta e autorit dhe pronësia intelektuale

1. Çdo student ose anëtar i stafit akademik është autor i veprës kërkimore që ka krijuar, në përputhje me Ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.”
2. Fakulteti gëzon të drejtën e përdorimit jo-komercial të veprës (për publikim, promovim dhe arkivim), me pëlqimin paraprak të autorit.
3. Në rastet kur punimi është realizuar me mbështetje financiare, logjistike ose kërkimore të Fakultetit, autorësia mbetet e autorit, ndërsa pronësia mbi rezultatet e aplikueshme mund të jetë e përbashkët midis autorit dhe Fakultetit.
4. Të gjitha veprat promovohen duke respektuar standardet e integritetit akademik dhe të citimit të burimeve.

Neni 7 – Patentimi dhe mbrojtja e rezultateve të kërkimit

1. Rezultatet kërkimore që përmbajnë elemente të reja dhe të zbatueshme në praktikë (metoda, produkte, teknologji, mjete digjitale, programe kompjuterike, mjete didaktike etj.) mund të jenë objekt patentimi ose mbrojtjeje të pronësisë industriale, në përputhje me Ligjin nr. 9947/2008, “Për pronësinë industriale.”
2. Autorët (studentë ose personeli akademik) që identifikojnë rezultate me potencial inovativ njoftojnë në mënyrë zyrtare Degën e Kualifikimit Shkencor dhe Botimeve të Fakultetit, e cila bashkëpunon me strukturat përkatëse të Universitetit të Tiranës për vlerësimin e patentueshmërisë.



3. Patentat ose të drejtat mbi shpikjet regjistrohen në emër të autorit, ose në bashkëpronësi me Fakultetin, kur projekti është realizuar me mbështetje institucionale ose financiare të tij.
4. Fakulteti ofron mbështetje ligjore dhe administrative për procesin e aplikimit për patentë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).
5. Të ardhurat që mund të rrjedhin nga përdorimi ose komercializimi i patentave ndahen sipas marrëveshjeve të brendshme ndërmjet autorëve dhe Fakultetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8 – Vlerësimi dhe promovimi i ekselencës akademike

1. Fakulteti krijon një komision Ad hoc për dhënien e vlerësimit “**Ekselencia akademike e Fakultetit**” për anëtarët e personelit akademik me arritje të spikatura në kërkim, publikim dhe inovacion.
2. Ky komision ka për detyrë të përcaktojë kriteret dhe procedurat e vlerësimit, të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: origjinalitetin e kontributit, ndikimin shkencor, publikimet ndërkombëtare, potencialin për inovacion si dhe kontributin në komunitetin akademik, profesional dhe shoqëror.
3. Komisioni përbëhet nga 5 deri në 7 anëtarë, dhe përfshin:
 - Zv. Dekanin për kërkimin shkencor (kryetar);
 - Dy pedagogë me titull Profesor nga fakulteti;
 - Një Bashkëpunëtor i jashtëm shkencor ose Profesor i ftuar nga një institucion vendas ose i huaj, i spikatur në fushën e kërkimit;
 - Një përfaqësues nga njësitë bazë (departamentet) përkatëse, që kanë zhvilluar projekte kërkimore gjatë periudhës së vlerësimit;
 - Një përfaqësues i grupeve mësimore–kërkimore.
4. Komisioni funksionon në përputhje me standardet e objektivitetit, transparencës dhe meritokracisë akademike.
5. Anëtarët e tij përzgjidhen bazuar në reputacionin profesional, eksperiencën kërkimore dhe publikimet në fusha me ndikim ndërkombëtar.
6. Komisioni mund të ftojë ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë për vlerësime të specializuara në disiplina të caktuara;
7. Vendimet merren me shumicë votash dhe përfshihen në Raportin vjetor të Fakultetit.

Neni 9 – Promovimi i punës kërkimore të doktorantëve

1. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja promovon dhe mbështet punën kërkimore të doktorantëve si pjesë e zhvillimit të kapaciteteve shkencore dhe akademike të institucionit.
2. Punimet kërkimore të doktorantëve mund të prezantohen në konferenca të organizuara nga Fakulteti, Universiteti i Tiranës ose partnerë ndërkombëtarë, si dhe të publikohen në revista shkencore me recension.
3. Fakulteti nxit bashkëpunimin ndërmjet doktorantëve dhe stafit akademik në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, me synim zhvillimin e kërkimit ndërdisiplinar dhe të inovacionit në fushat e studimit.



4. Për doktorantët me arritje të veçanta shkencore mund të akordohen çmime, certifikata mirënjohjeje ose mbështetje për pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë vendit, në përputhje me politikat e Fakultetit dhe rregulloren e Universitetit të Tiranës.
5. Fakulteti siguron publikimin dhe shpërndarjen e përmbledhjeve të disertacioneve të mbrojtura, në formë elektronike ose të shtypur, për të rritur dukshmërinë dhe vlerësimin e kontributeve shkencore të doktorantëve.

Neni 10 – Përzgjedhja e punimit më të mirë doktoral

1. Pas përfundimit të studimeve të ciklit të tretë Doktoratë dhe mbrojtjes së suksesshme të disertacionit, doktorantët kanë të drejtë të aplikojnë në thirrjen e Fakultetit për shpalljen e **Punimit më të mirë Doktoral**.
2. Për qëllimet e këtij vlerësimi ngrihet një **komision Ad hoc**, i cili përcakton kriteret specifike dhe procedurën e përzgjedhjes. Përzgjedhja bazohet, ndër të tjera, në kriteret e mëposhtme:
 - origjinaliteti i kërkimit;
 - ndikimi shkencor i studimit;
 - publikimet ndërkombëtare që burojnë nga puna doktorale;
 - potenciali për inovacion dhe aplikim praktik të rezultateve.
3. Fituesi shpallet gjatë **ceremonisë vjetore akademike** të fakultetit dhe përfshihet në promovimin institucional me titullin **“Doktoratura e vitit”**.

Neni 11 – Përzgjedhja e “Punimit më të mirë Master” nga Njësia bazë

1. Çdo njësi bazë formon një komision vlerësimi Ad hoc me jo më pak se tre (3) anëtarë, me përvojë në fushën përkatëse të cilët i përkasin kategorisë “Doktor i shkencave” ose “Profesor”. Komisioni drejtohet nga një pedagog me eksperiencë të njohur në udhëheqjen e punimeve kërkimore dhe në mbikëqyrjen e studimeve të ciklit të dytë.
2. Njësia bazë mbledh dhe verifikon të gjitha punimet e dorëzuara që plotësojnë kriterin formal të vlerësimit me notën më të lartë 10 (dhjetë). Komisioni shqyrton punimet në bazë të dokumentacionit përkatës dhe prezantimit paraprak të kandidatëve.
3. Komisioni përcakton dhe zbaton kriteret e vlerësimit, të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
 - origjinalitetin dhe rëndësinë shkencore të temës;
 - qartësinë metodologjike dhe cilësinë e analizës;
 - nivelin e argumentimit dhe përfundimeve;
 - aftësinë për aplikim praktik ose për kontribut akademik në fushën përkatëse;
 - cilësinë e paraqitjes dhe respektimin e standardeve akademike.
4. Komisioni harton një raport të shkurtër për secilin punim, duke argumentuar vlerësimin dhe duke renditur punimet sipas pikëve të marra. Komisioni shpall fituesin e çmimit “Punimi më i mirë Master i vitit akademik” për njësinë përkatëse.



5. Fituesi shpallet nga Dekani i Fakultetit gjatë një ceremonie zyrtare. Ai/ajo mund të nderohet me certifikatë mirënjohjeje dhe/ose shpërblim financiar, sipas mundësive dhe politikave të Fakultetit.
6. Fakulteti siguron publikimin e gjetjeve të punimeve më të mira Master në trajtën e artikujve shkencorë në revistën shkencore të FGJH-së.

Neni 12 – Bashkëpunimi institucional

Fakulteti bashkëpunon me:

- Universitetin e Tiranës dhe njësitë e tjera akademike;
- Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
- Institucione kërkimore, arsimore, ambasada dhe qendra kulturore;
- Platforma ndërkombëtare për kërkimin gjuhësor dhe përkthimin;
- Rrjete europiane kërkimore, Erasmus + dhe partneritet ndërkombëtare për kërkime të përbashkëta;
- Institucione jopublike, organizata jofitimprurëse dhe aktorë në fushën e sipërmarrjes.

Neni 13 – Roli i Degës së Kualifikimit Shkencor dhe Botimeve dhe Njësive Bazë

1. Dega për Kërkim Shkencor është përgjegjëse për koordinimin e veprimtarive kërkimore, promovimin dhe mbështetjen e studentëve, stafit akademik, njësive bazë dhe grupeve mësimore–kërkimore në procesin e arritjeve kërkimore–shkencore.
2. Ajo bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe grupet kërkimore për:
 - Hartimin dhe zbatimin e planeve vjetore dhe afatmesme të kërkimit shkencor, në përputhje me strategjinë e fakultetit dhe atë të Universitetit të Tiranës.
 - Nxitjen e projekteve bashkëpunuese ndërdepartamentale dhe pjesëmarrjen në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - Mbështetjen e grupeve mësimore–kërkimore në zhvillimin e aktiviteteve inovative, studimeve ndërdisiplinore dhe publikimeve shkencore.
 - Përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për aktivitetin kërkimor të fakultetit, duke evidentuar rolin aktiv të njësive bazë dhe kontributet kryesore të tyre.
 - Promovimin e rezultateve kërkimore dhe krijimin e sinergjive ndërmjet mësimdhënies, kërkimit dhe inovacionit.
3. Dega e kërkimit shkencor organizon trajnime dhe sesione mentorimi për shkrimin shkencor, kërkimin e financimeve, aplikimin për patenta, zhvillimin e ideve start-up dhe forcimin e kapaciteteve të grupeve mësimore–kërkimore.

Neni 14 – Promovimi i arritjeve

1. Arritjet shkencore dhe inovative të studentëve, stafit akademik dhe grupeve mësimore–kërkimore publikohen në faqen zyrtare të Fakultetit, në revistën shkencore të FGJH-së dhe në mediat sociale të saj.



2. Organizohen konkurse, veprimtari shkencore dhe prezantime për punimet më të mira në fusha të ndryshme shkencore dhe inovative.
3. Mbështetja financiare për pjesëmarrje në aktivitetet shkencore, konferenca, publikime ose projekte inovative realizohet në përputhje me politikat e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për ndihmën financiare ndaj studentëve dhe personelit akademik.
4. Institucioni organizon çdo vit një aktivitet të dedikuar, “Dita e Kërkimit Shkencor, Inovacionit dhe Arritjeve Studentore”, ku prezantohen projektet dhe arritjet e studentëve, stafit akademik dhe grupeve mësimore- kërkimore, duke rritur dukshmërinë dhe vlerësimin e punës shkencore në Fakultet.

Neni 15 – Zbatimi dhe monitorimi

Për zbatimin e kësaj rregulloreje përgjegjës është organi kompetent i Fakultetit për kërkimin shkencor.

Njësitë bazë dhe struktura të tjera përgjegjëse raportojnë periodikisht mbi arritjet e studentëve, stafit akademik dhe grupeve mesore kërkimore, si dhe propozojnë masa për përmirësimin e mekanizmave mbështetës dhe promovues, sipas nevojës.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi pas konsultimit nga personeli akademik dhe miratimit nga Dekanati dhe publikohet në faqen zyrtare të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Rregullorja mund të ndryshohet ose përditësohet sipas nevojave të Fakultetit dhe Universitetit të Tiranës, në përputhje me praktikën dhe politikat institucionale, për të përmirësuar mekanizmat e promovimit dhe mbështetjes së arritjeve kërkimore.

DEKAN

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

